

VENDIM
Nr. 420, datë 15.5.2013

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR USHTARAK DHE TË PROTOKOLLIT TË ZBATIMIT TË NDIHMËS FINANCIARE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për bashkëpunimin financiar ushtarak dhe të protokollit të zbatimit të ndihmës financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

E BASHKËPUNIMIT FINANCIAR USHTARAK NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË

Qeveria e Republikës së Turqisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (më poshtë të quajtura “palët”), me synim forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ushtarak dhe ofrimin e një kontributi për ristrukturimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, bazuar në lidhjet e qëndrueshme të miqësisë, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Qëllimi

Qeveria e Republikës së Turqisë i alokon Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë një burim financiar në total 2.425.000 (dy milionë e katërqind e njëzet e pesë mijë) TL/lira turke të barasvlershme në USD/dollarë amerikanë, bazuar në bashkëpunimin financiar ushtarak. Shuma prej 1.985.000 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë) TL/lira turke të barasvlershme në USD/dollarë amerikanë, vihen në dispozicion për blerjen e pajisjeve nga shoqëri lokale që operojnë në Turqi, kryesisht nga shoqëri të industrisë turke të mbrojtjes për qëllime ushtarake dhe pjesa e mbetur prej 100.000 (një qind mijë) TL/lira turke të barasvlershme në monedhën USD/dollarë amerikanë, do të fillojë të vihet në dispozicion pas hyrjes në fuqi të protokollit të zbatimit të asistencës financiare, që do të nënshkruhet pas arritjes së kësaj marrëveshjeje. Shuma e burimeve të alokuara që arrin 340.000 (treqind e dyzet mijë) TL/lira turke, të barasvlershme në monedhën USD/dollarë amerikanë, do të përdoret për modernizimin e projektit të Aeroportit të Kuçovës/Shqipëri sipas parimeve të protokollit të zbatimit logjistik, i cili nënshkruhet veçmas ndërmjet autoriteteve të të dyja palëve të përmendura në këtë marrëveshje.

Neni 2

Fusha e veprimit

Burimi financiar, që përfshin edhe kontributin prej 10% të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, arrin shumën 2.205.556 (dy milionë e dyqind e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) TL/lira turke të barasvlershme në monedhën USD/dollarë amerikanë, i vihen në dispozicion Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në formën e kontributit financiar për shpenzimet e pajisjeve dhe shërbimeve që do të blihen për qëllime ushtarake nga shoqëritë lokale në Turqi, kryesisht nga shoqëri të industrisë turke të mbrojtjes; burimi financiar që arrin deri 100.000 (njëqind mijë) TL/lira turke të barasvlershme në monedhën USD/dollarë amerikanë, vihet në dispozicion në formën e asistencës financiare sipas legjislacionit përkatës të Qeverisë së Republikës së Turqisë.

Neni 3

Autoritetet kompetente dhe pikat e kontaktit

Kjo marrëveshje zbatohet nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë në emër të Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe nga Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Pikat e kontaktit për këtë marrëveshje janë Zyra e Atasheut Ushtarak e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në Ankara/Turqi dhe Zyra e Atasheut Ushtarak të Republikës së Turqisë në Tiranë/Turqi.

Neni 4

Parimet e zbatimit

1. Në rast të blerjes së pajisjeve për qëllime ushtarake nga shoqëritë lokale që operojnë në Turqi, kryesisht shoqëri turke të industrisë së mbrojtjes me burime financiare që arrijnë deri 1.985.000 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë) TL/lira turke të barasvlershme në monedhën USD/dollarë amerikanë:

a) Nëse pajisjet dhe shërbimet e blera arrijnë shumën 2.205.556 (dy milionë e dyqind e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) TL/ lira turke të barasvlershme në monedhën USD/dollarë amerikanë dhe e tejkalojnë këtë shumë, atëherë 90% e shumës 2.205.556 (dy milionë e dyqind e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) TL/lira turke të barasvlershme në monedhën USD/dollarë amerikanë;

b) Nëse pajisjet dhe shërbimet e blera arrijnë shumën e më pak se 2.205.556 (dy milionë e dyqind e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) TL/lira turke të barasvlershme në monedhën USD/dollarë amerikanë, atëherë 90% e shumës së vlerës së pajisjeve dhe shërbimeve të blera,

vihet në dispozicion pas dhënies së urdhrat nga Ministria e Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë për Bankën Qendrore në zbatim të parimeve të marrëveshjes, duke i transferuar në numrin e llogarisë së shoqërisë, e cila ka realizuar prokurimin, dhe të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

2. Burimi financiar i alokuar Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë sipas kësaj marrëveshjeje, duhet të përdoret deri më 31 dhjetor 2017.

3. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë i dërgon listën e kërkesave të përcaktuara sipas burimit të alokuar (gjithashtu, duke përcaktuar prioritetet) Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë para ardhjes në Turqi për prokurim. Nën koordinimin e Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë, përcaktohen shoqëritë përkatëse dhe Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë fillon procesin e blerjes nga shoqëritë lokale që operojnë në Turqi, kryesisht shoqëri turke të industrisë së mbrojtjes.

4. Pagesat realizohen nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë në llogarinë bankare të shoqërisë së prokuruar dhe të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë pas plotësimit të kushteve të mëposhtme:

a) Nënshkrimin dhe përmbushjes së kontratës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë;

b) Deklarimit nëpërmjet një note diplomatike se pajisjet dhe shërbimet e blera nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë janë marrë në zotërim/dorëzuar;

c) Deklarimit nëpërmjet një note diplomatike se shuma e kontributit të Republikës së Shqipërisë është paguar nga ana e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

5. Në rast se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë realizon një blerje, e cila e tejkalon burimin financiar të alokuar dhe shumën e kontributit, i kërkohet që të transferojë burime shtesë kundrejt kontributit të tij. Qeveria e Republikës së Turqisë nuk realizon asnjë pagesë me vlerë më të lartë se shuma e caktuar në marrëveshje.

6. Shpenzimet, të cilat lidhen drejtpërdrejt me alokimin e burimit financiar, si: siguracioni, taksat, detyrimet bankare dhe ndryshimet e kursit të këmbimit, përcaktohen në kontratën e shitjes që do të lidhet ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë.

7. Vizitat që lidhen me procesin e prokurimit mund të fillojnë pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, sipas nenit 9 të saj. Shpenzimet e zyrtarëve të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që lidhen me këtë proces mbulohen nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.

8. 100.000 (njëqind mijë) TL/monedha turke, të barasvlershme në USD/dollarë amerikanë të asistencës financiare vihen në dispozicion sipas parimeve të Protokollit të Zbatimit të Asistencës Financiare, i cili do të nënshkruhet veçmas nga autoritetet e të dyja palëve të përmendura në këtë marrëveshje.

9. Burimi i alokuar nga Protokollit i Asistencës Financiare transferohet nga Ministria e Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë në numrin e llogarisë të Atasheut Ushtarak të Republikës së Turqisë në Tiranë/Shqipëri.

Neni 5

E drejta e përdorimit të mallrave dhe shërbimeve

1. Me anë të kësaj marrëveshjeje, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë bie dakord të paguajë të ardhurat e përfituara, duke përjashtuar nga inventari mallrat dhe shërbimet që do të transferohen nga Qeveria e Republikës së Turqisë, në numrin e llogarisë bankare që do të caktohet nga Qeveria e Republikës së Turqisë.

2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë bie dakord të mos transferojë mallrat dhe shërbimet ose të drejtat e tyre të përdorimit drejt një vendi tjetër apo pale të tretë, pa pëlqimin paraprak të Qeverisë së Republikës së Turqisë.

3. Kushtet e kësaj marrëveshjeje nuk cenojnë detyrimet që rrjedhin nga traktatet e tjera ndërkombëtare në të cilat të dy palët janë palë të përfshira dhe nuk duhet të përdoren kundër të drejtave, sigurisë dhe integritetit territorial të shteteve të tjera.

Neni 6

Siguria e informacionit të klasifikuar

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë nuk zbulon përmbajtjen dhe zbatimin e marrëveshjes apo informacionin e klasifikuar që mund të shkëmbehet mes palëve për një palë të tretë qeveritare, shoqëri apo person, pa pëlqimin me shkrim të Qeverisë së Republikës së Turqisë. Ky parim i konfidencialitetit do të vazhdojë të zbatohet edhe pas përfundimit të marrëveshjes.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast të një mosmarrëveshjeje që mund të lindë për shkak të zbatimit apo interpretimit të kësaj marrëveshjeje, mosmarrëveshja nuk i paraqitet asnjë pale të tretë, bordi arbitrazhi apo gjykatë ndërkombëtare dhe zgjidhet nëpërmjet bisedimeve.

Neni 8
Rishikimi dhe amendimi

1. Secila palë mund të propozojë rishikimin ose amendimin e kësaj marrëveshjeje. Në këtë rast, palët fillojnë diskutimet mbi rishikimin apo amendimin e çështjeve brenda maksimumi 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes së njoftimit me shkrim për rishikim.

2. Amendimet e rëna dakord me shkrim ndërmjet palëve hyjnë në fuqi në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 9.

3. Nëse nuk është arritur asnjë rezultat brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pas fillimit të konsultimeve, kësaj marrëveshjeje i jepet fund në përputhje me dispozitat e nenit 10.

4. Palët vazhdojnë të përmbushin detyrimet e tyre që rrjedhin nga kjo marrëveshje gjatë procesit të konsultimit.

Neni 9
Ratifikimi dhe hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me anë të të cilit palët njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike, mbi përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të marrëveshjes.

Neni 10
Kohëzgjatja dhe përfundimi

1. Kjo marrëveshje mbetet në fuqi deri në kohën kur burimi financiar i alokuar Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të jetë përdorur plotësisht, dhe me çdo kusht deri më 31 dhjetor 2017.

2. Në rast se një nga palët nuk është në gjendje të pajtohet apo arrin në përfundimin se pala tjetër nuk pajtohet me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, palët duhet të jenë në gjendje të propozojnë me shkrim organizimin e një konsultimi. Konsultimet në fjalë duhet të fillojnë brenda maksimumi 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes së njoftimit me shkrim. Nëse nuk arrihet asnjë rezultat brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve në vazhdim, secila palë i jep fund kësaj marrëveshjeje brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit me shkrim.

3. Dhënia fund e marrëveshjes për çdo lloj arsyeje nuk ndikon në zbatimin e dispozitave të përmendura në nenin 5 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 11
Teksti dhe nënshkrimet

Kjo marrëveshje hartohet në dy kopje origjinale në turqisht, shqip dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëllor autentike. Në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin për shkak të zbatimit të kësaj marrëveshjeje, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, të autorizuar ligjërisht si përfaqësues të të dyja palëve, kanë nënshkruar këtë marrëveshje më 25.12.2012, në Ankara/Republika e Turqisë.

NË EMËR SË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	NË EMËR TË QEVERISË TË REPUBLIKËS SË TURQISË
Nënshkrimi: Emri: SH.T.Z Altin Kodra	Nënshkrimi: Emri: Gjeneral brigade Mustafa Avcı

Pozicioni: Ambasador	Pozicioni: Nënsekretar për teknologjinë dhe koordinimin
-----------------------------	--

PROTOKOLLI I ZBATIMIT

NË LIDHJE ME ASISTENCËN FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISE SË REPUBLIKËS SË TURQISË

Qeveria e Republikës së Turqisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (më poshtë të quajtura “palët”) kanë rënë dakord mbi çështjet e mëposhtme për sa i përket asistencës financiare, që do të jepet në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit financiar ushtarak të datës 25.12.2012.

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij protokoll është përcaktimi i parimeve zbatuese të asistencës financiare në vlerën 100.000 (njëqind mijë) TL/lira turke të barasvlershme në USD/dollarë, e cila do të sigurohet nga Qeveria e Republikës së Turqisë për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Fusha e veprimit

Asistenca financiare që do të jepet nga ana e Qeverisë së Republikës së Turqisë do të përdoret për të mbuluar shpenzimet e kursit dhe të udhëtimit të personelit të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të vizitojnë Republikën e Turqisë, si dhe për të mbuluar detyrime të tjera të rastit.

Neni 3

Parimet e zbatimit

1. Burimi i dhënë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë sipas këtij protokoll duhet të përdoret deri më 31 dhjetor 2017.

2. Shuma prej 100.000 (njëqind mijë) TL/lira turke të barasvlershme në USD/dollarë jepet për të mbuluar shpenzimet e kursit dhe vizitës/udhëtimit të personelit të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të vizitojnë Republikën e Turqisë, si dhe për të mbuluar detyrime të tjera sipas rastit.

Shpenzimet e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të përcaktuara më poshtë do të mbulohen nga burimi i alokuar:

a) Shpenzimet e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët ndjekin Kurset e Partneritetit për Paqe dhe Qendrës së Mbrojtjes së Ekselencës kundër Terrorizmit, në shumën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) TL/lira turke të barasvlershme në dollarë amerikanë/USD;

b) Shpenzimet e vizitës zyrtare të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të vizitojnë Republikën e Turqisë, në shumën 20.000 (njëzet mijë) TL/lira turke të barasvlershme në dollarë amerikanë/USD;

c) Shpenzimet për të mbuluar nevojat e tjera që mund të lindin sipas rastit, në shumën 20.000 (njëzet mijë) TL/lira turke të barasvlershme në dollarë amerikanë/USD.

3. Asistenca financiare e dhënë sipas protokollit transferohet nga Ministria e Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë në llogarinë bankare të Atasheut Ushtarak të Republikës së Turqisë në Tiranë/Shqipëri. Burimi financiar përdoret nën mbikëqyrjen e Atasheut Ushtarak të Republikës së Turqisë në Tiranë/Shqipëri në kuadër të udhëzimeve të dhëna nga Shtabi i Përgjithshëm i Turqisë.

4. Transferimi i burimeve kur nevojiten realizohet nga ana e Shtabit të Përgjithshëm të Turqisë, sipas nevojës.

Neni 4

Siguria e të dhënave të klasifikuara

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë nuk zbulon përmbajtjen dhe zbatimin e protokollit ose të të dhënave të klasifikuara të shkëmbyera ndërmjet palëve, për një qeveri, shoqëri apo personi të një pale të tretë pa pëlqimin e Republikës së Turqisë. Ky parim i konfidencialitetit do të vazhdojë të zbatohet edhe pas përfundimit të protokollit.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje që mund të lindë për shkak të zbatimit apo të interpretimit të këtij protokollit, mosmarrëveshja nuk i paraqitet asnjë pale të tretë, bordi arbitrazhi apo gjykatë ndërkombëtare. Çdo mosmarrëveshje që lind gjatë zbatimit të këtij protokollit zgjidhet nëpërmjet bisedimeve.

2. Për sa u përket çështjeve që nuk mbulohen nga ky protokoll, zbatohen dispozitat përkatëse të “Marrëveshjes së bashkëpunimit financiar ushtarak” të nënshkruar më

3. Dispozitat e këtij protokollit nuk ndikojnë te të drejtat dhe detyrimet që lindin nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare të palëve.

Neni 6

Rishikimi dhe amendimi

1. Secila palë mund të propozojë rishikimin apo amendimin e këtij protokollit. Në këtë rast, palët fillojnë diskutimet brenda maksimumi 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit me shkrim në lidhje me këtë.

2. Amendimet e rena dakord nga palët me shkrim hyjnë në fuqi në përputhje me procedurat e përshkruara në nenin 7.

3. Në rast se nuk arrihet asnjë rezultat brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pas fillimit të konsultimeve, këtij protokollit do t’i jepet fund sipas dispozitave të nenit 8.

4. Palët vazhdojnë të përmbushin detyrimet e tyre që lindin nga ky protokoll gjatë procesit të konsultimit.

Neni 7

Ratifikimi dhe hyrja në fuqi

Ky protokoll hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me anë të të cilit palët njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, mbi përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të protokollit.

Neni 8

Kohëzgjatja dhe përfundimi

1. Ky protokoll mbetet në fuqi deri në përdorimin e plotë të burimit financiar të alokuar Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe me çdo kusht deri më 31 dhjetor 2017.

2. Në rast se një nga palët nuk është në gjendje të pajtohet apo arrin në përfundimin se pala tjetër nuk pajtohet me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, palët duhet të jenë në gjendje të propozojnë me shkrim organizimin e një konsultimi. Konsultimet në fjalë duhet të fillojnë brenda maksimumi 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes së njoftimit me shkrim. Nëse nuk arrihet asnjë rezultat brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve të ardhshme, secila palë i jep fund kësaj marrëveshjeje brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit me shkrim.

Neni 9

Teksti dhe nënshkrimi

1. Ky protokoll hartohet në dy kopje origjinale në gjuhën turke, shqipe dhe angleze, ku secili tekst është njëllëj autentik. Në rast të një mosmarrëveshjeje që mund të lindë për shkak të zbatimit të këtij protokollit, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

2. Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit e mëposhtëm, si përfaqësues të ligjshëm të autorizuar të të dyja palëve, kanë nënshkruar këtë protokoll më 25.12.2012, në Ankara/Republika e Turqisë.

NË EMËR SË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nënshkrimi:

Emri: SH.T.Z Altin Kodra

Pozicioni: Ambasador

NË EMËR TË QEVERISË TË REPUBLIKËS SË
TURQISË

Nënshkrimi:

Emri: Gjeneral brigade Mustafa Avci

Pozicioni: Nënsekretar për teknologjinë dhe koordinimin